1483. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje personale në ngarkim G.A. "Tomorica" nr.8016 me 1 volum me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin.1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1484. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje personale në ngarkim B. H. "Osumi" nr.8014 me 1 volum me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet.1989-1990. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1485. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje personale në ngarkim A. B. "Thëllëza" nr.861 me 1 volum me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet.1985-1987. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1486. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje formulare përpunim paraprak-2A në ngarkim L. J. "Krimbi" nr.780(710) me 1 volum me 102 (njëqind e dy) fletë. Dosja daton në vitet.1983-1990. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1487. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje formulare A. P. "Majmuni" nr.534 me 1 volum me 94 (nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet.1978-1980. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1488. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje perpunimi B. K. nr.813 me 1 volum me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet.1989-1990. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1489. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 5, dosje fashikull grupi kundër-revolucionist pa nr. me 1 volum me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin.1982. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

AIDSSH MARRËVESHJE ME AQSHF, PËR NJË QASJE E RE NË RISHIKIMIN E SË SHKUARËS PËRMES KINEMASË

Tiranë, 4 mars 2025



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim rikthimin e kujtesës kolektive përmes analizës së filmave dhe dokumenteve arkivore. Me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer, kjo nismë synon të hedhë dritë mbi realitetin e periudhës komuniste, duke vënë në fokus ndikimin e propagandës në kinemanë e kohës.

Çfarë sjell kjo marrëveshje?

“Klubi i Filmit” – një hapësirë diskutimi mbi filmat e realizmit socialist dhe përjasjen e tyre me dokumentet e Arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit. Shfaqje filmash dhe analiza historike për të nxjerrë në pah mesazhet e fshehura dhe për të dekonstruktuar propagandën e kohës. Diskutime me studiues, kineastë dhe ekspertë mbi ndikimin e këtyre filmave në shoqërinë shqiptare. Projekti do të angazhojë akademikë, studentë, përfaqësues të mediave: RTSH dhe AMA, si dhe institucione vendore, duke ofruar një platformë për reflektim mbi të shkuarën.

Historia duhet ballafaquar me dokumentet. Filmat propagandistikë krijuan një realitet të shtrembëruar, duke ndikuar në perceptimin e historisë dhe përçmuar kundërshtarët politikë. Përmes kësaj nisme AIDSSH-ja dhe AQSHF-ja synojnë të sjellin një analizë të thelluar për të ndarë faktet nga manipulimi dhe për të ndihmuar në ndriçimin e të kaluarës sonë.

KLUBI I LIBRIT “MËSOJMË NGA E KALUARA” DISKUTON LIBRIN “DRITË QË VJEN NGA HUMNERA”

Korçë, 4 mars 2025



Klubi i Librit “Mësojmë nga e kaluara” vijoi takimet e tij në bibliotekën “Thimi Mitko” në Korçë, duke u fokusuar te libri “Dritë që vjen nga humnera”, ditari dhe poezitë e Drita Çomos.

Takimi u hap nga Dr. Metin Venxha, pedagog në Universitetin e Korçës dhe anëtar i klubit, i cili moderoi aktivitetin dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Ai përshëndeti të pranishmit, mes të cilëve pedagogë, mësues dhe studentë, duke nënvizuar se ky është takimi i tretë i Klubit të Librit në Korçë.

Në vijim të aktivitetit, pjesëmarrësit analizuan dosjen eurvejimit të Drita Çomos, e hapur nga ish-Sigurimi i Shtetit më 24 dhjetor 1974, kur ajo ishte vetëm 16.

Studiuesit theksuan se fati i saj tragjik lidhej me faktin se ishte vajza e Maqo Çomos dhe Liri Belishovës, të cilët u dënuan si armiq të popullit vetëm sepse kishin shprehur mendime në kundërshtim me vijën e partisë. Rrjedhimisht, edhe Drita, një vajzë e re me intelekt të zhvilluar dhe shpirt poetik, u përdoq nga regjimi, pavarësisht moshës së saj dhe gjendjes shëndetësore.



Drejtori i Informacionit në AIDSSH, z. Selami Zalli, u ndal te rëndësia e dokumenteve arkivore për të kuptuar historinë ashtu siç ka ndodhur. “Për të mësuar historinë duhet t’i referohemi dokumenteve, t’i ballafaqojmë me dëshmitë, në mënyrë që të mos lejojmë përsëritjen e saj në të ardhmen”, theksoi ai.

Dr. Edlir Orhani, specialist i AIDSSH-së, bëri një paraqitje të detajuar të gjetjeve arkivore nga dosja e përndjekjes së Drita Çomos dhe dokumenteve për nënën e saj, Liri Belishova. Ai shpjegoi sesi përndjekja e të dyjave shkonte paralelisht dhe si Sigurimi i Shtetit përdorte metoda represive për të ndëshkuar të ashtuquajturit kundërshtarë të partisë. “Në këtë dosje shohim mekanizmin e shtetit totalitar në veprim. Një vajzë e mitur, e cila duhej të ishte e mbrojtur, shndërrohet në një objekt kontrolli dhe ndëshkimi, vetëm për shkak të prejardhjes së saj”, tha ai.



Elona Baçi, specialiste AIDSSH, solli një qasje analitike mes librit dhe dokumenteve arkivore. Ajo sqaroi gjithashtu se si ditari mund të përdoret si burim historik për të ndriçuar të kaluarën dhe për të reflektuar mbi shkeljet e të drejtave njerëzore.

Mësuesit pjesëmarrës theksuan rëndësinë e këtij libri në edukimin e brezit të ri. Ata nënvizuan se “Dritë që vjen nga humnera” është pjesë e listës së rekomandimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe se ky takim i ndihmon ata të trajtojnë librin më thellë në mësimdhënie. “Pasi dëgjua analizën e dokumenteve arkivore dhe historinë e Dritës, e shohim këtë libër me një sy tjetër. Nxënësit tanë do të kuptojnë jo vetëm forcën e fjalës, por edhe realitetin e një epoke që nuk duhet harruar,” thanë ata.

Takimi u mbyll me reflektime mbi rëndësinë e dokumentimit të së kaluarës dhe nevojën për të vazhduar studimet mbi fatet individuale që ndriçojnë historinë kolektive të vendit.

VIZITORË TË VEGJËL NË ARKIV: TË NJOHIM DIKTATURËN PËRMES EKSPOZITAVE DHE TEK-STEVE PËR FËMIJË

Tiranë, 5 mars 2025

Në kuadër të edukatës qytetare dhe vizitave në arkiva, nxënësit e klasave të pesta të shkollës “Gustav Mayer” vizituan Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Gjatë vizitës, 93 nxënës dhe 3 mësues patën mundësinë të eksploronin katër ekspozitat e ndryshme të vendosura në hollin dhe hyrjen e godinës së Autoritetit. Ekspozitat përfshinin “Siluetat”, “Portretet e Spaçit”, “Tumos” dhe logot e Spaçit, të krijuara nga nxënësit e shkollave artistike.





Pas eksplorimit të ekspozitave, nxënësit vizituan bibliotekën “Musine Kokalari”, ku ndoqën një prezantim mbi “Të drejtat e njeriut dhe diktaturën”, i përgatitur posaçërisht për këtë grupmoshë. Prezantimi përshkroi në një formë të thjeshtë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe shkeljet e këtyre të drejtave gjatë periudhës së diktaturës, duke përdorur ilustrime dhe përshkrime të thjeshta. Nxënësit mësuan për të drejtat e lirisë së shprehjes, mendimit, besimit, lirisë së lëvizjes, dhe të drejtën për barazi para ligjit.

Pas diskutimeve mbi të drejtat e njeriut, ata u njohën me mënyrat se si regjimi totalitar i ka shkelur këto të drejta në Shqipëri, përmes fragmenteve nga libri “Dielli lind në Spaç”, botim i AIDSSH-së, i përshtatur për arsimin 9-vjeçar. Nxënësit dëgjuan gjithashtu dëshmi të fëmijëve që kishin të afërm në Spaç, duke u thelluar kështu në realitetin e diktaturës dhe përvojat e asaj periudhe.

Pjesëmarrësit u inkurajuan të diskutonin dhe të ilustronin të drejtat e njeriut përmes vizatimeve, dhe të angazhoheshin në analizimin e situatave për t’u informuar sa më mirë. Në fund të vizitës, mësuesve u dhurua një kopje e librit “Dielli lind në Spaç”, me qëllim stimulimin e projekteve edukative jashtëshkollore mbi njohjen e së kaluarës dhe vlerat e të drejtave të njeriut.

Fëmijët shpërndanë mendimet e tyre përmes vizatimeve dhe fjalëve:

“Këtu kam bërë një vajzë që është e lirë sepse të drejtat e saj nuk cenohen”, shpjegoi Reina.

“Unë kam vizatuar një person që ka të drejtë të jetojë i lirë. Të gjithë duhet të jenë të barabartë dhe të mos u preken të drejtat”, tha Kledi.

“Kam dëgjuar për kohën e diktaturës nga familja dhe nga televizori”, shtoi një tjetër nxënëse.

Ky aktivitet solli një mundësi për nxënësit që të reflektojnë mbi të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e njohjes së historisë, duke u angazhuar në mënyrë aktive në procesin edukativ.

TURI I LEXIMIT ME KIE– SHKOLLA 9- VJEÇARE “BAJRAM CURRI”

Tiranë, 10 mars 2025

Rifillon për vitin 2025 iniciativa e përbashkët “Të mësojmë nga e kaluara” mes AIDSSH-së dhe projektit të Këshillit të Evropës, “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri” financuar nga SIDA, me rrugëtimin në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në vend.



Më 10 mars u zhvillua takimi i parë i Turit të Leximit, për këtë vit me nxënësit e shkollës 9-vjeçare publike “Bajram Curri” në Tiranë, ku të pranishëm ishin edhe mësuesit. Takimi u mbajt në sallën “Musine Kokalari” në AIDSSH.

Nxënësit u njohën me ekspozitat me punime të nxënësve të shkollave artistike në vend dhe të qendrës “Tumo” të krijuara në përkujtim të 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit, të vendosura në hollin institucionit.

Takimi vijoi në bibliotekën “Musine Kokalari”. Fjalën e hapjes e mbajti përfaqësuesja e KiE-s e cila theksoi rëndësinë e këtij turi që vjen në kuadër të projektit të sipërpërmendur.



Më pas nxënësit u njohën me misionin e AIDSSH-së në shërbim të edukimit qytetar. Nxënësit u njohën me kampin-burg të Spaçit, revoltën dhe të drejtat e shkelura të njeriut, nëpërmjet librave “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte”. Nxënësit lexuan pjesë nga dëshmitë e fëmijëve që kanë takuar të afërmit e tyre në Spaç, dhe që janë publikuar në librin “Dielli lind në Spaç”. Në vijim ndoqën dokumentarin e shkurtër për të rinj, “3 ditët e lirisë në Spaç” dhe diskutuan mbi dëshmitë dhe faktet e sjella në dokumentar.

Znj. Vilma Mirakaj solli para tyre historinë e jetës së saj në kampet e internimit duke ndarë me nxënësit mungesën e të drejtave të njeriut në kohën e diktaturës. Pas këtij bashkëbisedimi, nxënësit plotësuan pyetësorin që ka për qëllim të kuptojë sesa informacion kanë përvetësuar nxënësit gjatë këtij takimi, si dhe të nxisë mendimin e tyre kritik në lidhje me temën e diskutuar.

Njëra nga mësueset theksoi rëndësinë e njohjes së të kaluarës në mënyrë që gabimet e bëra të mos përsëriten. Në përfundim të takimit, një nga nxënëset recitoi një poezi kushtuar disidentit Marie Tuçit.

TURI I LEXIMIT ME KIE– SHKOLLA 9- VJEÇARE “HASAN PRISHTINA”

Tiranë, 12 mars 2025

Nxënësit e shkollës publike 9-vjeçare “Hasan Prishtina” vizituan AIDSSH-në në kuadër të iniciativës së përbashkët “Të mësojmë nga e kaluara” mes AIDSSH-së dhe projektit të Këshillit të Evropës, “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, financuar nga SIDA.





Në fillim nxënësit panë ekspozitat e Spaçit, me krijime nga nxënës të shkollave artistike në vend dhe të qendrës “Tumo”. Takimi vijoi në bibliotekën “Musine Kokalari” ku nxënësit nga përfaqësuesja e KiE-me projektin dhe turin e leximit dhe rëndësisë së njohjes së të shkuarës dhe turit të leximit. Në vijim nxënësit mësuam çfarë është dhe çfarë bën AIDSSH-ja në shërbim të edukimit qytetar dhe bashkëpunimi me projektin e Këshillin e Evropës “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”.



Nxënësit u njohën me botimet e shkruara për Arsimin Parauniversitar, si “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte”, libra të cilët hedhin dritë mbi periudhën e errët të regjimit komunist dhe të drejtat e njeriut në atë kohë. Nxënës dhe mësues lexuan pjesë nga dëshmitë e fëmijëve që kanë takuar të afërmit e tyre në Spaç, dhe që janë publikuar në librin “Dielli lind në Spaç”.

Z. Ioann Celi solli para nxënësve historinë e jetës së tij dhe vuajtjes së familjes pas arrestimit të babait.

Në mbyllje të takimit nxënësit vizituan dhe arkivin e AIDSSH-së.

TURI I LEXIMIT ME KIE– SHKOLLA 9- VJEÇARE “MYREDIN BASHALLI”

Lin, Pogradec, 13 mars 2025



Në kuadër të informimit dhe edukimit qytetar u zhvillua takimi i tretë i Turit të Leximit, për vitin 2025 në shkollën 9-vjeçare “Myredin Bashalli” në Lin të Pogradecit.

Si në çdo takim, nxënësit plotësuan pyetësorët përpara dhe pas takimit, të cilët shërbejnë për të krahasuar sa njohuri kanë dhe sa mësojnë pas aktivitetit mbi kampin-burg të Spaçit.

Për rëndësinë që paraqet njohja e së të shkuarës dhe Turit të Leximit nxënësit mësuam nga përfaqësuesja e zyrës së KiE-s, e cila theksoi rëndësinë e këtij turi që vjen në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, i mbështetur nga SIDA dhe u njohën gjithashtu mbi rolin dhe punën e AIDSSH-së në funksion të edukimit qytetar.



Nëpërmjet librave “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte” nxënësit u njohën me kampin-burg të Spaçit, revoltën e ndodhur në këtë burg dhe të drejtat e shkelura të njeriut, lexuan pjesë nga dëshmitë e fëmijëve që kanë takuar të afërmit e tyre në Spaç, të publikuara në librin “Dielli lind në Spaç”.

U prezantuan punët e nxënësve të kësaj shkolle në pikurë përgatitur për këtë takim me tematikë kampin burg të Spaçit.

Rreth 30 nxënës të klasave të 6-9 dhe 4 mësues ishin të pranishëm në takimin e zhvilluar në mjediset e kësaj shkolle. Për bibliotekën e shkollës u dhuruan 6 libra nga titujt “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte”.

TURI I LEXIMIT ME KIE- SHKOLLA E MESME PUBLIKE “ARBËRIA” NË BULQIZË

Bulqizë, 18 mars 2025



Vijojnë takimet e Turit të Leximit në shkolla në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, të mbështetur nga SIDA.

Ekipi i zyrës së KiE-s së bashku me ekipin e AIDSSH-së vijuan turin në shkollën e mesme publike “Arbëria” në Bulqizë.

Takimi u zhvillua sipas agjendës, nxënësit plotësuan pyetësorët u njohën me projektin, mësuan për veprimtarinë e AIDSSH-së në raport me edukimin, si edhe botimet “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte”

Nxënësja Asimina Alla vlerësoi librin “Dielli lind në Spaç” për nga rrëfimi, informacioni i ofruar dhe ilustrimet dhe ndau para bashkëmoshatarëve të saj, disa nga pjesët e librit. Më tej nxënësit biseduan mbi të drejtat e njeriut dhe rolin e individit në një shoqëri demokratike.

Rreth 26 nxënës të klasës së 12-të dhe 1 mësues ishin të pranishëm në takimin e zhvilluar në mjediset e shkollës. Në përfundim të takimit nxënësit plotësuan pyetësorin 2 dhe më pas u shpërnda për ta libri “Spaç, historia e një revolte”. Për bibliotekën e shkollës dhe mësuesen u dhuruan 6 libra nga “Spaç, historia e një revolte”.



TURI I LEXIMIT ME KIE– SHKOLLA E MESME PUBLIKE “OSO KUKA”, SHKODËR

Shkodër, 26 mars 2025



U zhvillua Turit i Leximit në shkollën e mesme të përgjithshme “Oso Kuka” në Shkodër. Takimi u zhvillua në bibliotekën e shkollës në të cilin morën pjesë rreth 35 nxënës të dhe 3 mësues.

Në këtë takim nxënësit dhe mësuesit u njohën nga përfaqësuesja e zyrës së KiE-s mbi rëndësinë e këtij turi në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, të mbështetur nga SIDA.

Nga specialistët e AIDSSH-së pjesëmarrësit mësuan rolin që institucioni luan në informimin e qytetarëve me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe punën që kryen ky institucion në shërbim të edukimit qytetar.



Si pjesë e edukimit qytetar janë librat e botuar nga AIDSSH për të rinjtë rreth të cilëve u diskutua në takim. Gjatë këtij takimi nxënësit panë dokumentarin “3 ditët e lirisë në Spaç”, bashkëpunim i AIDSSH-së me Këshillin e Europës. Njëra nga nxënëset u shpreh se nga ky takim “mësova shumë gjëra të reja në lidhje me diktaturën, gjëra që nuk i kisha dëgjuar më parë.” Mësuesja e histori-gjeografisë Mirela Sakej e vlerësoi takimin duke vënë theksin tek informacionet konkrete mbi diktaturën dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri dhe bashkëbisedimin me nxënësit. Mësuese Audenarda Balliu shprehu entuziazmin mbi informacionet e marra për Burgun e Spaçit të padëgjua më parë.

STUDIUES TË PROJEKTIT EUROPIAN “SLOW MEMORY” VIZITË NË AUTORITETIN PËR INFORMIM MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

Tiranë, 27 mars 2025

Akademikë, profesorë dhe studiues nga universitete ndërkombëtare dhe rajonale, pjesë e projektit të Bashkimit Europian “Slow Memory”, që bashkëpunon me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë përmes Qendrës së Studimit të Arteve, zhvilluan sot një vizitë zyrtare në Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).

Gjatë takimit pjesëmarrësit u njohën me përvojën dhe praktikën e Shqipërisë në hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, procesin e dekomunistizimit dhe drejtësinë tranzicionale. Diskutimi përfshiu çështje kyçe, si: rikuperimi i trupave të zhdukurve gjatë regjimit komunist dhe edukimi i brezave të rinj përmes projekteve ndërgjegjëse dhe edukative.

Takimi u drejtua nga anëtarët e Autoritetit të Dosjeve, z. Altin Hoxha, z. Gjergj Marku dhe z. Skënder Vrioni, të cilët ndanë përvojën vendase dhe rolin e institucionit në promovimin e një kujtese historike të drejtë. Diskutimi u përqendrua në shfrytëzimin e dokumenteve arkivore për të ndriçuar të shkuarën dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik, me synimin që e kaluara të mos përsëritet.





Z. Altin Hoxha prezantoi punën e institucionit në informimin e qytetarëve, studiuesve dhe mediave mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, procesin e deklasifikimit dhe dixhitalizimin e arkivave, si dhe bashkëpunimet me institucionet homologe dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Z. Gjergj Marku foli mbi ngritjen e strukturës së posaçme për të zhdukurit gjatë komunizmit dhe iniciativat për zbardhjen e historive të burgjeve politike, si ai i Spaçit.

Ndërsa z. Skënder Vrioni prezantoi rolin e Autoritetit si një qendër studimi dhe diskutimi mbi fatin e viktimave të së shkuarës. Ai përmendi edhe projektet më të fundit në fushën e edukimit, si platforma me burime të hapura arsimore “Mësojmë nga e kaluara” dhe Klubi i Librit, të cilat synojnë informimin e mësuesve të arsimit parauniversitar për ngjarjet historike të periudhës 1944-1991, me qëllim përcjelljen e tyre tek brezat e rinj.



Projekti “Slow Memory” është pjesë e rrjetit europian të kërkuesve Cost Action CA20105 dhe fokusohet në studimin e mënyrave sesi shoqëritë përballen me të shkuarën e tyre, ndërsa përballen me ndryshime të papritura ekonomike dhe shoqërore.

Pjesëmarrësit nga Franca, Mbretëria e Bashkuar, Kroacia, Serbia, Danimarka, Kosova dhe Shqipëria patën mundësinë të njihen me arkivin e institucionit, tipologjinë e dokumenteve dhe proceset e punës, përfshirë dixhitalizimin, ekspozitat dokumentare dhe angazhimin me të rinjtë përmes dokumentarëve dhe dëshmive të ish-të përndjekurve politikë.

TURI I LEXIMIT ME KIE– QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE, DURRËS

Durrës, 28 mars 2025

Në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri” të mbështetur nga SIDA, u mbajt takimi i radhës së Turit të Leximit në Qendrën Kulturore të fëmijëve, Durrës. Në takim morën pjesë rreth 30 nxënës të cilët ishin talente të letërsisë dhe artit nga të gjitha shkollat e qytetit të Durrësit. Ata u njohën nga përfaqësuesja e zyrës së KiE-s mbi rëndësinë e këtij turi, si edhe nga specialistët e AIDSSH-së pjesëmarrësit mësuan rolin që institucioni luan në informimin e qytetarëve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe punën që kryen ky institucion në shërbim të edukimit qytetar, pjesë e të cilit janë librat e botuar nga AIDSSH për të rinjtë, rreth të cilave u diskutua në takim duke u zhvilluar një bisedë interaktive me këto talente.

Gjatë këtij takimi u shfaq edhe dokumentari “3 ditët e lirisë në Spaç” bashkëpunim i AIDSSH-së me Këshillin e Evropës. Një nga nxënëset pjesëmarrëse foli se ky takim i kishte ngjallur kuriozitet për të mësuar më shumë për të kaluarën. Të gjithë pjesëmarrësit shprehën interes për të marrë pjesë në konkursin përmbyllës së këtij turi.



DOSJA E HAPUR – TIRANA NË SYTË E SIGURIMIT- DISKUTOJMË PËR LEJLA GJINALIN BESHIRIN

Tiranë, 2 prill 2025

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) organizoi aktivitetin “Dosja e Hapur – Tirana në Sytë e Sigurimit”, me qëllim ndërgjegjësimin mbi ndikimin e diktaturës komuniste në jetën e intelektualëve dhe familjeve të njohura të kohës.

Gjatë aktivitetit, anëtari i Autoritetit, z.Skënder Vrioni, theksoi rolin e projektit “Tirana në Sytë e Sigurimit”, i cili ka nisur në vitin 2022, si një platformë për të eksploruar persekutimin e personaliteteve publike. Ai solli në vëmendje historinë e familjes Gjinali-Beshiri dhe theksoi se diktatura synonte të shkatërronte mendimin e lirë.



Drejtori i Drejtorisë së Informacionit, Selami Zalli, analizoi dokumentet arkivore të AIDSSH-së, duke vënë në dukje rëndësinë e ruajtjes dhe shpërndarjes së tyre përmes aktiviteteve publike dhe dialogëve me komunitetin.

Nevila Turdiu trajtoi kontributin e familjeve Tahiri dhe Gjinali në zhvillimin e vendit, me theks te Lejla Gjinali, pionierja e pianos në Shqipëri, dhe bashkëshorti i saj, Eshref Beshiri, topograf i shquar. Ata u persekutuan pas vdekjes së Enver Hoxhës dhe u internuan në vitin 1986.

Studiuesja Enxhi Beka trajtoi tipologjinë e regjimeve totalitare, të cilat kundërshtojnë çdo formë pushteti ekonomik dhe intelektual. Ajo theksoi se në thelb të regjimeve totalitare qëndronte makineria e shpikjes së armikut, duke ndjekur parimin se nëse armiku nuk ekziston, ai duhet të shpiket. Znj. Beka prezantoi konceptin e trashëgimit të “ADN-së së armikut” brez pas brezi, duke e konkretizuar me familjen Gjinali. Për shkak të pushtetit ekonomik dhe intelektual, kjo familje u shpall armike e regjimit. Tahir Gjinali vuajti 15 vjet burgim, ndërsa Lejla dhe Eshref Beshiri u internuan në vitin 1986. Vajza e madhe, Aida, u internua dhjetë ditë pas lindjes së fëmijës, dhe vajzës tjetër, Mirandës, iu mohua e drejta për të studiuar violinë.

Aktivitetin e përshëndeti kryetari i Shoqatës Tirana, z. Ruzhdi Keçi, i cili vlerësoi përpjekjet e AIDSSH-së për të dokumentuar dhe ndarë historinë e persekutimit komunist me publikun.

Në takim foli edhe vajza e Lejlës dhe Eshref Beshirit, Miranda, e cila falënderoi dhe përgëzoi AIDSSH-në për organizimin e këtij aktiviteti. Ajo ndau historinë e saj personale dhe sfidat e para si emigrante në Itali pas rënies së komunizmit. “Komunizmi synonte të luftonte trashëgiminë sepse trashëgimia është themeli që ndërton shoqërinë”, u shpreh Miranda në përfundim të fjalës së saj.

Aktiviteti përfundoi me një diskutim mbi rëndësinë e transparencës historike dhe angazhimin e AIDSSH-së për të vijuar me nisma të ngjashme, duke kontribuar në edukimin e brezave të rinj mbi të kaluarën komuniste.

TURI I LEXIMIT ME KIE– SHKOLLA E MESME “SINAN TAFAJ”, TIRANË

Tiranë, 3 prill 2025



U zhvillua takimi i radhës së Turit të Leximit në AIDSSH, në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, të mbështetur nga SIDA me nxënës të shkollës së mesme “Sinan Tafaj”. Në takim ishin pjesëmarrës 22 nxënës të vitit të dytë të shoqëruar nga 2 mësuese.

Pjesëmarrësit u njohën nga përfaqësuesja e zyrës së KiE-s mbi rëndësinë e këtij turi në kuadër të projektit. Përmes prezantimeve të specialistëve të AIDSSH-së ata u njohën edhe me rolin që institucioni luan në informimin e qytetarëve me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe punën që kryen ky institucion në shërbim të edukimit qytetar, pjesë e të cilit janë librat e botuar nga AIDSSH, si: “Dielli lind në Spaç” dhe “Spaç, historia e një revolte” dhe u prezantua për herë të parë në këtë takim i libri “Kufij të thyer”.

TURI I LEXIMIT ME KIE– SHKOLLA “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Vlorë, 8 prill 2025



Në mjediset e shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali” në Vlorë u mbajt takimi i Turit të Leximit në kuadër të informimit dhe edukimit qytetar. Takimi vijoi sipas agjendës nxënësit u njohën me nismën e Turit të Leximit dhe informimit nga përfaqësuesja e zyrës së KiE-s, u njohën mbi rolin dhe punën e AIDSSH-së në përgjithësi dhe veçanërisht në aspektin e informimit dhe edukimit qytetar, si edhe mbi rolin e ish-Sigurimit të Shtetit, në kohën e regjimit diktatorial nga nëpunës të AIDSSH-së.


Takimi vijoi me prezantimin e materialeve të përgatitura në kuadër “Mësojmë nga e kaluara” të prezantuara nga Roven Rrozhani. Nxënësit u njohën me të drejtat kryesore të njeriut dhe shkeljen e tyre gjatë kohës së diktaturës nëpërmjet botimeve të AIDSSH-së të përshtatura për ciklin parauniversitar. Ata u informuan mbi kampin-burg të Spaçit, revoltën e vitit 1973 dhe të drejtat e shkelura të njeriut në diktaturë dhe veçanërisht me të drejtën e lirisë së lëvizjes. Prezantimet u ndërthurën me lexime të librave nga nxënësit. Takimi vijoi me shfaqjen e dokumentarit të shkurtër “3 ditët e lirisë në Spaç”. Më pas nxënësit patën mundësinë që të dëgjonin dëshminë e ish të burgosurit politik në Spaç, z. Agron Hoxha.

Për nxënësit u shpërndanë librat “Dielli lind në Spaç” dhe “Kufij të thyer” dhe fletëpalosje mbi Spaçin sipas dëshirës së tyre. Fotografitë, videot dhe mbështetja logjistike u realizuan nga Dorian Zanalio.



TURI I LEXIMIT ME KIE- SHKOLLA “ARIF KUKA”, PËRRENJAS

Tiranë, 9 prill 2025



Rreth 25 nxënës së shkollës “Arif Kuka”, të Përrenjasit erdhën në mjediset e AIDSSH -së, si pjesë e shkollave në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri” të mbështetur nga SIDA për të cilin u foli përfaqësuesja e zyrës së KIE-s. Nga nëpunësit e AIDSSH-së nxënësit u njohën mbi rolin dhe punën e AIDSSH-së në përgjithësi dhe veçanërisht në aspektin e informimit dhe edukimit qytetar, si edhe mbi rolin e ish-Sigurimit të Shtetit.

Takimi vijoi me prezantimin e materialeve të përgatitura në kuadër të këtij projekti ku nxënësit u njohën me të drejtat kryesore të njeriut dhe shkëlqen e tyre gjatë kohës së diktaturës nëpërmjet botimeve të AIDSSH-së të përshtatura për ciklin parauniversitar. Takimi vijoi me shfaqjen e dokumentarit të shkurtër “3 ditët e lirisë në Spaç”.

Pas dokumentarit nxënësit patën mundësinë që të dëgjonin dhe t’i drejtonin pyetje ish të burgosurit politik në Spaç, z. Agron Hoxha.

Për nxënësit u shpërndanë librat “Dielli lind në Spaç” , “Kufij të thyer” dhe fletëpalosje për Spaçin.



TURI I LEXIMIT ME KIE– GJMNAZI “PROTAGONISTËT”, TIRANË

Tiranë, 10 prill 2025



Rreth 17 nxënës të gjmnazit “Protagonistët” të shoqëruar nga 3 mësues, vizituan ambjentet e AIDSSH ku u zhvillua takimi i fundit i Turit të Leximit, i cili ka për qëllim informimin dhe edukimit qytetar në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri” të mbështetur nga SIDA dhe i realizuar nga AIDSSH në bashkëpunim me KiE.

Ata u njohën nga përfaqësuesja e zyrës së KiE-s mbi rëndësinë e këtij turi si edhe nga nëpunës të AIDSSH-së pjesëmarrësit mësuan rolin që institucioni luan në informimin e qytetarëve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Gjithashtu u diskutua dhe rreth librave të botuar nga AIDSSH për të rinjtë “Dielli lind në Spaç” dhe “Kufij të thyer”.

Në përfundim të takimit nxënësit patën mundësi të dëgjonin rrëfimet e znj. Ajkana Toni e cila tregoi për takimet me të atin në burg dhe znj. Vilma Miraka e cila foli për jetën në internim. Në varësi të dëshirës së tyre të rinjtë morën botime të AIDSSH.

THEMELOHET KLUBI I LIBRIT -MËSOJMË NGA E KALUARA” NË QYTETIN E SARANDËS – DIS-KUTIM MBI LIBRIN “BIRI I ARMIKUT”

Sarandë, 11 prill 2025

Në mjediset e bibliotekës “Bilal Xhaferri”, në Sarandë, u themelua Klubi i Librit “Mësojmë nga e kaluara” me librin “Biri i armikut” të publicistit Nebil Çika (i riu).

Takimi u mbajt në përvjetorin e largimit të parakohshëm të autorit. Në këtë libër autori paraqet historinë e familjes Çika dhe persekutimin e anëtarëve të kësaj familjeje gjatë regjimit komunist.

Në takim merrnin pjesë familjarë, përfaqësues të bashkisë, anëtarë të Autoritetit, përfaqësues të ISKK-së, miq e mësues. Fjalën e përshëndetjes e mbajti kryetari në detyrë, z. Altin Hoxha. Në nisje u mbajt një minutë zie në nder të kujtimit të tij. Duke falënderuar pjesëmarrësit, ai theksoi rolin e rëndësishëm të informimit dhe rrugëtimin e vetë Nebilit për njohjen e dosjes së familjes së tij dhe përmbushjen e amanetit të babait për të shkruar këtë libër: “Autoriteti kishte një mik dhe ka humbur një mik. Ka punuar me autoritetin për të zbardhur dosjet.”



Nga fjala e dërguar e kryetares së Autoritetit, znj. Gentiana Sula, z. Altin Hoxha, ndër të tjera lexoi:

“Në librin “Biri i armikut”, ai hapi një dritare për brezin e të persekutuuarve, duke rrëfyer historinë e paraardhësve të tij – plot dhembje, qëndresë dhe dinjitet dhe me stil...

Një fjalë për familjen e Nebil Çikës: kurajë! Ata na frymëzojnë të nderojmë të vërtetën. Një fjalë për të parët: qëndresë. Sakrificat e tyre janë themeli i drejtësisë sonë.

Ky aktivitet është një udhëtim në veprën e Nebil Çikës, një ftesë për të kuptuar plagët e diktaturës dhe guximin për të thënë të vërtetën.

Në AIDSSH, ne hapim dosjet që e shkuara të jetë mësim, jo barrë që rrezikon përsëritjen.”



Djali i Nebilit, Gazmir Çika u shpreh: “Ky libër nuk është vetëm një dëshmi personale, por një kontribut i çmuar ndaj kujtesës historike kombëtare – një përpjekje për ta ruajtur të vërtetën në formën më njerëzore të saj. Në një kohë kur historia shpeshherë mbetet e paplotë, apo interpretohet në mënyra të ndryshme, të tilla rrëfime e pasurojnë narrativën kolektive dhe na ndihmojnë të ndërtojmë ura mirëkuptimi mes brezave.”

Brunilda Çërraga, shpjegoi rëndësinë e njohjes së brezit të ri me këtë lloj letërsie dhe transmetimin e historisë dhe të vërtetave në këto libra: “Të rinjtë e kanë ende të vështirë të shpjegosh të shkuarën, të rinjtë nuk e kuptojnë, nuk e besojnë e kanë vështirë të pranojnë. Historia e Sigurimit të Shtetit, e vuajtjeve, persekucionit, dhimbjes dhe dëmit që ai solli në jetët e shumë familjeve, njerëzve të pafajshëm, është një pjesë e papërfshirë në programet mësimore. Me librat që trajtojmë në klubin e librit “Mësojmë nga e kaluara” vendosim librin e zhanrit memuaristik përballë dosjeve të ish sigurimit. Përmes këtyre librave, ne i afrohem mësuësve, që ata t’ia afrojnë nxënësve – përmes orëve jashtëkurrikulare.”



Znj. Brunilda Çërraga falënderoi edhe një herë përfaqësuesit e ISKK-së si botuesit e librit “Biri i armikut” dhe i përcolli falënderimet kryetarit të këtij institucioni z. Çelo Hoxha.



Në fjalën e tij, z. Hekuran Halili, kryetar i Klubit të Krijuesve Jonianë shpjegoi se: “Ky libër nuk është thjesht një përkujtim i jetës dhe veprës së fisit, gjyshit, babait, birit. Ai është një akt drejtësie shpirtërore të munguar për padrejtësitë e bëra ndaj tyre. Libri përçon zërin e munguar të atyre që nuk mundën të flisnin, heshtën të detyruar me forcë, ndërsa eshtrat e tyre kallur burgjeve, kampeve të internimit na flasin me gjuhën e dhimbjes, të nderit, të qëndresës. Autori i librit, Nebili, këta njerëz i ka njohur drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet rrëfimeve të babait të tij, Sorkadhit, të cilit kam dëshirë t’ia përmend emrin shpesh, se është një nga emrat më të



bukur të bijve shqiptarë, i kthen në simbole të dinjitetit njerëzor, në një tokë që shpesh e ka kafshuartë vërtetën nën baltën e harresës.”

Z. Selami Zalli, Drejtori i Drejtorisë së Informacionit theksoirëndësinë e procesit të informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit për t’u njohur me të vërtetën dhe përdorimi i tyre si një burim nga ku mund të lindin krijime artistike me bazë historike: “Këto krijime do të jenë një mjet më shumë që brezat e rinj të njihen me të vërtetën me qëllim që gabimet e së kaluarës të mos përsëriten.” Ai shpjegoi për publikun disa dokumente nga dosja në mënyrë që të kuptohej më mirë mekanizmi i persekutimit të regjimit, kohën e gjatë të persekutimit, elementet biografikë që përkufizonin “elementin armik”.

Specialistja e Drejtorisë së Informacionit, Mirela Murrizi, në punimin e saj “Libri përballë dosjeve të ish- Sigurimit të Shtetit- Biri i armikut, përballja me hijet e së shkuarës” bëri një ndërthurje të librit me elementë të dosjes duke dhënë një panoramë shpjeguese të persekutimit që u shtri në të gjithë familjen për gjithë periudhën e shtrirjes së regjimit; kronologjisë e vuajtjes në burgje, kampe pune dhe internime, si dhe elementeve të rëndësishme që nxjerrin tiparet represive të regjimit. Gjatë paraqitjes u lexua një episod nga libri nga nxënësja e shkollës Renalda Xhelili duke e sjellë më afër moshës mënyrës sesi trajtohej që në shkollë “djali i armikut”.



Znj. Murrizi theksoi gjithashtu se amaneti i babait të Nebilit “për të fshirë pluhurin e harresës, në një farë mënyrë është edhe misioni në vazhdim, për të mos harruar.”

Në punimin e saj, në formën e disa reflektimeve për librin, mësuesja Natasha Xhelili thekson se “Ky libër është më shumë se kujtim. Është paralajmërim. Dhe mbi të gjitha, është një thirrje për përgjegjësi: për të mos harruar, për të mos heshtur, për të mos lejuar që një kohë kaq tragjike të relativizohet apo të mbulohet me harresë. Historia, për të qenë mësim dhe për të shpëtuar brezat e rinj, nuk duhet të mbetet e patrajtuar dhe e pastruar nga mitet dhe gënjeshttrat që janë ngritur për të fshehur abuzimet.”

Pas paraqitjeve të sipërpërmendura, pati mjaft diskutime mbi Nebil Çikën, kontributin e tij në publicistikë, në shoqatën e ish të përndjekurve nga miq e bashkëpunëtorë. Në vijim kujtuan mësuesi Halil Shabani, Feruz Pulaj i cili lexoi edhe një poezi për Nebilin Riki Nikolla, etj.

Takimin e mbylli kryetari në detyrë, z. Altin Hoxha duke falënderuar edhe një herë dhe duke gjetur rastin për të parë mundësinë e propozimit të një titulli nderi vendor për figurën e Nebil Çikës.

VIZITË ZYRTARE E AUTORITETIT TË DOSJEVE NË INSTITUTIN E HISTORISË “ALI HADRI” NË PRISHTINË

Prishtinë, 16 prill 2025



Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e studimeve historike dhe kërkimeve arkivore, përfaqësuesit e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilluan një vizitë zyrtare në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Delegacioni i Autoritetit i përbërë nga z. Altin Hoxha, z. Albert Nikolla, z. Gjergj Marku dhe zyrtarë të tjerë të institucionit u prit nga drejtuesit e Institutit, përkatësisht drejtoresha znj. Teuta Shala, sekretari shkencor z. Arbër Hadri, anëtarët e Këshillit Drejtues, si dhe studiuesit z. Isuf Bajraktari dhe z. Frashër Demaj.

Takimi u përqendrua në shkëmbimin e ideve dhe vizioneve për thellimin e bashkëpunimit në fushat e kërkimit dhe botimeve shkencore, me fokus të veçantë në dokumentimin e periudhës së diktaturës komuniste, kujtesën historike dhe garantimin e aksesit publik në dokumentacionin arkivor.

Gjatë vizitës, z. Altin Hoxha prezantoi misionin e Autoritetit dhe theksoi rëndësinë e projektit për përpunimin e fondit arkivor “Kosova”, i cili pritet të lehtësojë ndjeshëm qasjen e studiuesve dhe qytetarëve në të dhëna me rëndësi historike.

Në këtë kontekst, drejtori i Informacionit, z. Selami Zalli dhe specialisti i kërkimit shkencor, z. Edlir Orhani, ndanë me të pranishmit pjesë përfaqësuese nga dosja e personalitetit Ali Hadri, duke nënvizuar rëndësinë e përfshirjes së figurave të shquara në trajtimin e kujtesës historike.

Shkëmbimi dhe çelja e dyerve arkivore mes Shqipërisë dhe Kosovës nuk ka vetëm rëndësi historike e akademike, por përfaqëson një akt domethënës të afrimit dhe ndërveprimit mes dy shteteve që ndajnë një gjuhë, një identitet kombëtar dhe një histori të përbashkët mbijetese. Ky bashkëpunim kontribuon në rishqyrtimin kritik të së kaluarës dhe në ndërtimin e një të ardhmeje më të ndërgjegjshme dhe të lidhur.

Të dyja institucionet shprehën angazhimin për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm, përmes projekteve të përbashkëta kërkimore, organizimit të aktiviteteve akademike dhe nismave që synojnë edukimin e brezave të rinj me të vërtetën historike dhe ruajtjen e trashëgimisë dokumentare.

ÇDO QENIE E ZHDUKUR KA NJË FYTYRË, NJË EMËR DHE NJË HISTORI. ËSHTË DETYRA JONË T’I KTHEJMË NË DRITË

Prishtinë, 17 Prill 2025

Delegacioni i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), i udhëhequr nga z. Altin Hoxha (kryetar në detyrë) dhe i shoqëruar nga z. Gjergj Marku, z. Albert Nikolli, znj. Nertila Seitaj, z. Selami Zalli dhe znj. Irma Bataj, zhvilloi një takim pune në Prishtinë me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur, nën drejtimin e z. Andin Hoti.

Takimi u fokusua në shkëmbimin e praktikave më të mira për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, si dhe ndërtimi i urave të reja bashkëpunimi humanitar e institucional.

Pas prezantimeve institucionale, së bashku zhvilluam homazhe në Poklek dhe Çikatova e Vjetër në komunën e Drenasit, ku kujtuam dy prej masakrave më të rënda të 17 prillit 1999.

Nderuam sakrificën e grave, fëmijëve, pleqve e burrave që humbën jetën dhe dëgjua rrëfimin drithërues të zotit Sinan Muqolli në Shtëpinë-Muze “Muqolli”.

Faleminderit Komisionit Qeveritar të Personave të Zhdukur në Kosovë për mikpritjen dhe gatishmërinë për t’i shërbyer së vërtetës dhe drejtësisë së familjeve të të zhdukurve.

“Secili i zhdukur ka një fytyrë, një emër dhe një histori. Është detyra jonë t’i kthejmë në dritë!”

AIDSSH VIZITË ZYRTARE NË INSTITUTIN ALBANOLOGJIK NË PRISHTINË

Prishtinë, 18 prill 2025

Përfaqësues të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shteti vijuan vizitën zyrtare në Institutin Albanologjik në Prishtinë ku u pritën nga drejtori i Institutit, z. Naim Berisha, dhe stafi akademik: z. Adil Olluri – Sekretar shkencor, Nurdin Ahmeti – Shef i Degës së Historisë, znj. Angjelina Hamza-Hasanaj – Shefe e Degës së Etnologjisë, z. Gëzim Aliu – Shef i Degës së Letërsisë z. Mustafë Shala – Sekretar i përgjithshëm për çështje administrative dhe juridike znj. Bleronë Zylfiu – Zyrtare për burime njerëzore

Në fokus të takimit ishte ndërtimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet dy institucioneve, me qëllim lehtësimin e qasjes së studiuesve të Institutit Albanologjik në dokumentet arkivore që administrohen nga Autoriteti i Dosjeve. Këto dokumente përmbajnë informacione me vlerë për hulumtime në fushat e historisë, etnologjisë, letërsisë dhe albanologjisë në përgjithësi.

Z. Altin Hoxha dhe z. Naim Berisha shprehën gatishmërinë për të ndërtuar ura bashkëpunimi përmes një marrëveshjeje të mirëfilltë institucionale, e cila do të mundësojë shkëmbim informacioni, përkrahje për kërkimin shkencor dhe organizim të përbashkët të aktiviteteve akademike.

Ekspertë të arkivit të AIDSSH-së prezantuan tipologjitë e dokumenteve të lidhura me fondin “Kosova”, si dhe materiale të rëndësishme që pasqyrojnë ngjarje historike të dokumentuara nga ish-Sigurimi i Shtetit.



“ASGJË PËR T’U MALLËNGYER NË VILËN 31” – VIJNË PËRSHTYPJET NGA VIZITORËT, NUK E NJIHNIM KËTË MEKANIZËM TERRORI



Në ambientet simbolike të Vilës 31, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit çeli një ekspozitë dokumentare që solli në vëmendje disa nga tipologjitë më të veçanta të dokumenteve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, si dhe botime të ndryshme që pasqyrojnë veprimtarinë e AIDSSH.

Ekspozita u mirëprit me interes të madh nga vizitorë të të gjitha moshave. Ajo u ofroi atyre mundësinë të njiheshin nga afër me një pjesë të errët, por thelbësore të historisë sonë, përmes dokumenteve autentike dhe materialeve të rralla arkivore që flasin me zë të heshtur, por të fuqishëm.

Veçanërisht domethënëse ishte kureshtja e të rinjve, të cilët shfaqën dëshirë për të kuptuar më shumë rreth mekanizmave të kontrollit dhe survejimit që dikur përshkonin çdo shtresë të jetës shoqërore. Ky interes i gjeneratave të reja është dëshmi e nevojës për njohje, reflektim dhe ndërgjegjësim.

Ndër vizitorët nuk munguan as të huajt, të cilët panë në këtë ekspozitë një dritare të vlefshme për të kuptuar më mirë pasojat e një regjimi të izoluar dhe rëndësinë që kanë dokumentet arkivore në zbardhjen e së vërtetës historike.

Shumë prej të rinjve që vizituan ekspozitën ndanë përshtypje të thella, duke theksuar kontrastin midis realitetit të asaj kohe dhe lirisë që ata gëzojnë sot.

“Nuk e kisha imagjinuar që dikur njerëzit survejoheshin për një fjalë a një letër”, – tha një studente. “Kjo ekspozitë më bëri të kuptoj pse është e rëndësishme të mbrojmë lirinë e shprehjes dhe të mos harrojmë çfarë kemi kaluar si shoqëri.” Për shumë prej tyre, ishte hera e parë që përballeshin me dokumente të vërteta që dëshmojnë mekanizmin e frikës, duke e kthyer këtë përvojë në një ndërthurje të fortë emocionesh, habie dhe reflektimi.

Çdo përpjekje, pavarësisht kritikave të natyrave të ndryshme, duhet parë në dritën e qëllimit të saj: a ia vlejti apo jo. Në këtë rast, mendojmë se po. Ekspozita jonë e vogël, e vendosur aty në atë vilë, është vizituar dhe parë me interes. Madje, shumë prej vizitorëve na kanë sjellë foto dhe përshtypje nga vizita e tyre — një gjest i thjeshtë, por që flet shumë për lidhjen që krijohet kur historia rrëfëhet me ndershmëri dhe përkushtim.

Kjo ekspozitë është edhe fryt i një përpjekjeje personale të kryetares së Autoritetit për të mos ia lënë rastësisë historinë e Vilës 31 si një hapësirë elitare, ku mbizotëronte kurioziteti për arkitekturën apo interiorin që mund të gjeneronin nostalgji të panevojshme për një shoqëri që ka vuajtur gjatë nën komunizëm.

Përkundrazi, synimi ishte që aty, në një kat të asaj ndërtese, të vendosej një kujtesë dokumentare e mekanizmit përmes të cilit diktatura terrorizoi vendin për 45 vjet.

Përmes kësaj ekspozite, Autoriteti përforcon misionin e tij për të promovuar transparencën, kujtesën historike dhe ndërgjegjësimin publik mbi të kaluarën — një detyrë që nuk njih moshë, por fton çdo qytetar të bëhet pjesë e kujtesës kolektive.

“JETA E TË TJERËVE” - NJË DOKUMENTAR I JASHTËZAKONSHËM NGA PRIME TIME

Kamera e emisionit Prime Time dhe gazetari Christos Nikolaidis udhëtuan në Shqipëri për të dokumentuar të kaluarën e errët të diktaturës komuniste. Nga kampi famëkeq i Spaçit, ku të burgosurit politikë u torturuan në mënyrë çnjerëzore, deri në Tiranë — në ambientet e Autoritetit të Dosjeve — ku të mbijetuarit përballen me dosjet e tyre dhe të familjarëve, të mbushura me akte të pabesueshme survejimi dhe dhune.

Një nga historitë më prekëse është ajo e Kristo Canos — i cili për herë të parë zbulon dosjen e vet, të babait dhe të vëllait. Ai rrëfen vuajtjet e familjes së tij, torturat, presionet për të bashkëpunuar me Sigurimin, refuzimin për të gënjyer dhe për të tradhtuar të tjerët.

“Nëna më tha: ‘Aman bir, se mund të mbetesh pa fëmijë nga torturat’, por nuk pranova. Sot kam fëmijë dhe jam i lumtur. Paraja nuk është asgjë — mua më duhet vetëm mirësia te njerëzit.”

Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit të Dosjeve, i prezantoi Kristo Canos dokumentet e tij, duke shpjeguar me imtësi se çfarë


thuhet në të dhe për gazetarin shpjegoi kush ishte “armiku i popullit” në komunizëm, si ndërtoheshin dosjet, çfarë përmbanin dhe ku qëndronte sekreti i këtyre dokumenteve – që edhe sot vazhdojnë të tronditin ndërgjegjen shoqërore.

E shoqëruam ekipin e gazetarëve në sallat arkivore ku në mijëra dollapë metalikë fle jeta e ish-të burgosurve politikë – tashmë të deklasifikuara – që regjimi kishte hartuar kundër tyre.

Në faqet e zverdhura të tyre, ata lexojnë akuzat që u ishin ngritur, të bazuara në dëshmi të paqëndrueshme të informatorëve – bashkëfshatarë, miq apo edhe të afërm.

Tridhjetë e pesë vite pas fillimit të fundit të regjimit komunist në vendin fqinj dhe dyzet vite pas vdekjes së Enver Hoxhës, kamera e emisionit nga televizioni Sky në Greqi, ndjek ish të dënuarit politik nga një moment në tjetrin, bashkë me rrëfimin e tyre si u gjetën në izolim, pas dymëzave të rënda prej hekuri, më pas në ferrin e Spaçit – kampin famëkeq të asgjësimit të të burgosurve politikë, ku iu nënshtruan torturave çnjerëzore.

Ky dokumentar është një thirrje për reflektim, drejtësi dhe kujtesë historike.





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETËTIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni "Skënderbej", Tiranë